



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Arta Haxhiu, me titull:

“Sjellja dhe preferenca e konsumatorit Kosovarë për verë” ndodhet në diskutim publik 7 ditë, nga datë 16 deri me datë 22.09.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Muje Gjonbalaj - mentor
2. Prof. Asoc. Jehona Shkodra - anëtar
3. Prof. Dr. Bedri Dragusha - anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonit te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj, përmes e-mail adresës muje.gjonbalaj@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak, më poshtë gjeni një përmbledhje të shkurtër të temës në fjalë.

Çdo sygjërim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI AGROEKONOMI
PROGRAMI EKONOMI E BUJQËSISË DHE USHQIMIT



Tema:

“Sjellja dhe preferenca e konsumatorit Kosovarë për verë”

Mentor:

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

Kandidati:

BSc. Arta Haxhiu

Prishtinë, 2024

PËRMBLEDHJE

Sektori i vreshtarisë dhe verëtarisë në Kosovë është një ndër sektorët që luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e bujqësisë të vendit. Për arsye të ndryshme ky sektor përballet me shumë probleme gjatë prodhimit dhe përpunimit të verërave. Një nga problemet aktuale dhe shumë i rëndësishëm për vendin është sjellja dhe preferencat e konsumatorëve Kosovar për konsumimin e verërave.

Sjellja e konsumatorit mbi konsumimin e verës në Kosovë, është një proces shumë kompleks të hulumtohet. Ky punim analizon dhe përmbledh gjetjet kryesore në lidhje me sjelljen e konsumatorit për konsumimin e verës vendore. Po ashtu qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizoj marëdhëniet midis sjelljeve dhe qëndrimeve të konsumatorëve të verës dhe synimit për të blerë verë vendore në Kosovë.

Anketa është kryer në një mostër heterogjene nga 100 respondent, kryesisht konsumator të verës vendore , realizimi i anketave është kryer ne vitin 2020, gjatë periudhës kohore Covid-19. Për arsye të gjendjes pandemike realizmi i anketave është kryer përmes pyetësorit online. Të dhënat janë futur dhe përpunuar në Programin Statistikor (SPSS) ndërsa janë përdorur modele të zakonshme statistikore për interpretimin e rezultateve dhe hipotezave të testuara.

Fjalët kyçe: verërat, sjellja e konsumatorit, preferencat e konsumatorit, SPSS, Kosova.